

PASURIA GJUHËSORE E AKAD. REXHEP QOSJES PJESË E KRITIKËS SHKENCORE TË PROF. SHEFKIJE ISLAMAJT

Abdurrahim MAXHUNI

Instituti Albanologjik, Prishtinë

Abstrakt

Studiuesja Shefkije Islamaj studimeve të gjuhësisë shqiptare u solli një tjetër vepër të vyer, cilësore dhe mjaft vëllimore. Kësaj radhe nën llupën e saj prej shkencëtareje të dëshmuar dhe prodhimtare ishte ligjërimi, gjuha dhe stili në krijimtarinë letrare të Akademik Rexhep Qosjes, e një shkrimtari e mbi të gjitha e një studiuesi të pashoq brenda dhe jashtë hapësirave shqiptare. Realizimi i kësaj pune kapitale e studiueses Shefkije Islamaj, vjen pas një pune pararendëse për dy figura të shquara të letërsisë shqiptare, të Jakov Xoxës dhe të Gjergj Fishtës, duke e kurorëzuar me këtë të Rexhep Qosjes dhe duke përfshirë tri periudha të rëndësishme letrare: Rilindjen Kombëtare, realizmin dhe modernizmin-postmodernizmin. Në këtë kumtesë do të ndalemi te gjuha e ligjërimit i prof. Rexhep Qosjes nga këndvështrimi i prof. Shefkije Islamajt.

Fjalët kyçe: Shefkije Islamaj, ligjërimi, gjuha, stili, Rexhep Qosja.

Hyrje

Për ndërmarrje të mëdha shkencore, ku në opusin shkencor do të ishin emra të mëdhenj shkencorë, përveç guximit kërkohet përgatitje profesionale e njohuri të thella shkencore. E tillë është profesoreshë Shefkije Islamaj, e cila bën pjesë në vargun e paktë të studiuesve që trajton problematika me një qasje pothuajse shteruese në raport me materialin shkencor që e trajton. Veprimtaria e saj e begatë shkencore përfshin monografi, studime, kumtesa, trajtesa, artikuj, recensione për problematika të ndryshme të fushave të ndryshme, si të leksikografisë, të leksikologjisë, të stilistikës, të shqipes standarde, të kulturës së gjuhës etj. Në këto vepra ajo ka trajtuar çështje, probleme, tema, ngjarje e përvjetorë të ndryshëm. Me studimet e saj të thelluara, ajo i ka pasuruar studimet shqiptare me anë të ndryshme të shikimit e të trajtimit të temave e të çështjeve gjuhësore, me metodologji, me përvoja kërkimore e shkencore në përgjithësi.¹ Profesoreshë Shefkije Islamaj, për ndihmesën e vyer shkencore është vlerësuar nga emra të njohur të studimeve shqiptare e të huaj. Vend të veçantë për vlerësimin e veprimtarisë së saj shkencore i është kushtuar në konferencën shkencore, me rastin e 65-vjetorit të lindjes së saj, organizim i Institutit Albanologjik, ku edhe ka vepruar për më tepër se 40 vjet.

Akad. Rexhep Qosja emër i shquar i albanologjisë

Veprimtaria krijuese e profesor Qosjes është e madhe dhe rrok dekada të tëra e rreth 3000 faqe material, që konsiderohet si përfaqësuesi më i veçantë i letërsisë postmoderne shqipe. Duke u nisur nga vëllimi i punës krijuese të profesor Qosjes, realizmi i një monografie të tillë, sigurisht se ka kërkuar mund të madh për ta vënë në pah pasurinë e kësaj pune dhe për ta vjellë më të mirën e saj. Por, duke e pasur parasysh përgatitjen shkencore të profesoreshë Shefkije Islamaj, përvojën e gjatë dhe sprovimin e kaluar me sukses të studimit të gjuhës dhe stilit të dy autorëve të mëdhenj të letërsisë shqipe, nuk i është frikësuar punës vëllimore të profesor Qosjes, duke iu

¹ Rexhep Qosja, *Shefkije Islamaj – porterti intelektual, shkencore dhe letrar*, në Shefkije Islamaj, porterti intelektual, shkencor dhe letrar, Prishtinë, 2018, f. 25.

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v12.i23-24.p2931>

përveshur mëngët për vite të tëra dhe duke e kurorëzuar punën e saj me monografinë 827 faqe nën titullin *Ligjërimi, gjuha dhe stili në krijimtarinë letrare moderne dhe postmoderne të Rexhep Qosjes*. Në këtë monografi, autorja ka studiuar gjuhën dhe stilin e prozës së tij artistike, pa lënë anash semantikën e poetikën e saj, duke dëshmuar se profesor Qosja është krijues i madh me vëllimin e veprave, me vizionin largpamës, me stilin e përsosur dhe modern, është individualitet kompleks dhe komplet, kurse vepra e tij e madhe në sasi e në cilësi është shprehje jo vetëm e dhuntisë po sidomos është shprehje e një pune të madhe, të mundimshme, sistimore e të disiplinuar, shprehje e një thellësie mendimesh e ndjenjash pambarimisht të pasura e të larmishme.

Monografia *Ligjërimi, gjuha dhe stili në krijimtarinë letrare moderne dhe postmoderne të Rexhep Qosjes* kushtuar gjuhës dhe stilit të profesor Qosjes, pos hyrjes ka pesë ndarje të mëdha: *Stilistika leksiko-semantike, Stilistika sintaksore, Stilistika tekstore-ligjërimore, Stilistika ligjërimore, Figurshmëria dhe teknika postmoderne*.

Për krijimtarinë letrare dhe për vendin e profesor Qosjes, janë mbajtur shumë konferenca dhe janë botuar shumë punime shkencore e monografi, por kjo punë vëllimore dhe e mundimshme shpërfaq më së miri dhe përfshin aspekte të ndryshme të punës së palodhshme të profesor Qosjes. Duke folur për Rexhep Qosjen studiuesja Islamaj, shprehet se ai është krijues i madh me vëllimin e veprave, me vizionin largpamës, me stilin e përsosur dhe modern, është individualitet kompleks, kurse vepra e tij e madhe në sasi e në cilësi është shprehje jo vetëm e dhuntisë po sidomos është shprehje e një pune të madhe, të mundimshme, sistimore e të disiplinuar, shprehje e një thellësie mendimesh e ndjenjash pambarimisht të pasura e të larmishme.² Ndërsa për gjuhën e romaneve të Rexhep Qosjes, shprehet se është gjuha standarde me kufij të zgjeruar. Asaj nuk mund t'ia veshësh treguesit a asnjë idiome organike, edhe pse brenda saj përdallojnë veçori të dialektit gegë, në rend të parë elementet leksikore të ligjëritit gegë, por edhe shmangie të qëllimshme në nivele të ndryshme gjuhësore. Gjuha e romaneve të Qosjes është gjuha standarde në kuptimin jo vetëm të përfshirjes, por edhe të krijimit të risimeve gjuhësore të nevojshme për shprehjen e tij gjuhësore-artistike.³

Normësia gjuhësore në romanet e tij shihet në të gjitha rrafshet deri te ajo drejtshkrimore. Megjithatë, kjo normë nuk e ka kuptimin e rregullsisë së ngurtë, por është mjet i përpunimit dhe i ripërpunimit artistik të lëndës letrare-gjuhësore. Sipas Islamajt, Qosja, ka shfrytëzuar gjerësisht mundësitë dhe mjetet gjuhësore dhe me krijimtarinë e tij në këtë fushë ka zgjeruar e thelluar këto mundësi e këto mjete. Krijimtaria e tij gjuhësore artistike dhe risimet përfshijnë më së shumti rrafshin leksikor dhe sintaksor, në mënyrë të ndjeshme edhe rrafshet morfologjike e fonetike. Leksiku i romaneve të Qosjes është i pasur dhe i larmishëm dhe duhet të vlerësohet sipas kriterëve leksikologjike, fjalëformuese dhe stilistike, shprehet Islamaj. Ndërsa për elementet dialektore të pranishme në romanet e Qosjes, shprehet se elementet dialektore janë të përfillshme, por kjo nuk na jep të drejtën që autorin ta quajmë shkrimtar dialektor, përkundrazi, sepse përdorimi i idiomave dialektore, përkatësisht i elementeve dialektore në nivele të ndryshme gjuhësore, gjithmonë është motivuar nga qëllime artistike dhe gjithmonë mund të konsiderohen si letrare. Edhe pse në shikim të parë jo i përdorur me dënduri të shquar, leksiku me treguesin e vjetërsisë (arkaizmat), që ende jeton në idiomat dialektore, zë një vend të përfillshëm në këtë roman, si p.sh. *kanicë e kalencë, kanicore, kamxhikoj, lëshojkë, zhgunajë, patllake, rrospiallak, apuzh, llokmaxhi* etj.

Përveç përdorimit të arkaizmave e elementeve dialektore, leksiku i Qosjes shquhet edhe për fjalëkrijime, të krijuara, në të shumtën e herës, sipas gjedheve të njohura të fjalëformimit të shqipes, ndër të cilat mbizotërojnë ato me ndajsthim dhe përngjitje, si: *syhaptësi, sipëri, paskajësi, përhim, gjithëfuqi, faqekuqërremtë, fulqinjëgjerë, mesarak, bojëtulle, puthadorës, heshtak, lajmsjellës, lavdimadh* etj. Sipas Islamajt, Qosja, është treguar i vëmendshëm

² Shefkije Islamaj, *Ligjërimi, gjuha dhe stili në krijimtarinë letrare modern dhe postmoderne të Rexhep Qosjes*, Prishtinë, 2021, f. 30.

³ Po aty, f. 47.

posaçërisht në përdorimin e fjalës. Për të janë shumë të rëndësishme shprehësia fonetike e morfologjike, shprehësia leksikore e sintaksore, ngjyresat shprehëse-emocionale, që krijohen me mjete leksikore, fjalëformuese dhe gramatikore. Ai po ashtu ka shfrytëzuar, gjithnjë në funksion të shprehësisë stilistike poliseminë, sinoniminë, antoniminë dhe leksikun me tregues kohorë dhe burimorë, siç janë arkaizmat, historizmat, orientalizmat, neologjizmat dhe dialektizmat.

Pasuria leksikore në veprimtarinë e Akad. Rexhep Qosjes

Pasuria leksikore në krijimtarinë e Qosjes është e madhe dhe e gjerë. Duke u nisur nga ky fakt, studiuesja Islamaj thekson se është e nevojshme të kemi një studim monografik gjuhësor, ku do të studiohej aspekti gjuhësor, stilistik, ligjërimor dhe tekstori për të nxjerrë në pah pasurinë leksikore. Megjithatë, në këtë studim studiuesja Islamaj në pjesën stilistika leksiko-semantike ka rrokur aspekte të ndryshme të leksikut të profesor Qosjes, ndër të cilat: leksiku emocional-ekspresiv dhe leksiku me ngjyime funksionale-stilistike; leksiku i vjetruar si arkaizmat e historizmat, neologjizmat stilistikë; sinonimia, ku ka studiuar llojet e sinonimisë, si sinoniminë e plotë, sinonimin e pjesshme, vargun sinonimik, çiftet sinonimike, variacionet sinonimike dhe sinonimin kontekstuale; antonimia, ku ka pasqyruar llojet e saj, si: antonimet me rrënjë të ndryshme, antonimet me rrënjë të njëjtë, çiftet antonimike, antonimet e plota dhe të pjesshme, antonimet kontekstuale dhe ato sipas kategorive gramatikore.

Autorja ka zbuluar e ka konkretizuar me shembuj të shumtë disa veçori sintaksore të reja ose të njohura, interesante dhe me interes në përballje me ligjësitë e strukturave të njohura sintaksore, si rendi i fjalëve në fjali, llojet e ligjërimit, llojet e fjalive, strukturat e qëndrueshme frazeologjike e sintagmatike, sinonimin sintagmatike, inversionin, elizionin, elipsën etj. Këto karakteristika sintaksore i ka përfshirë në pjesën e dytë të monografisë *sintaksa stilistike*, ku autorja ka vjelë dhe ka trajtuar materialin vëllimor, duke e ndarë në kapitujt: shprehësia sintaksore, grumbullimi (akumulimi), stilistika e ngjyresave-shkallëzimit, anasjella, fjalitë eliptike dhe shprehësia, pyetjet retorike dhe leximi stilistik-sintaksor. Kështu, autorja shprehet se saktësia, qartësia dhe ngjeshja semantike janë veçoritë kryesore të prozës së Rexhep Qosjes, me ç'rast sintaksa e tij prek dy skajet sintaksore: gjatësinë dhe shkurtësinë.

Neologjia në veprimtarinë e Akad. Rexhep Qosjes

Qosja në romanet e tij rëndësi u ka kushtuar edhe neologjizmave. Neologjizmat përfaqësojnë tregues thelbësorë të shprehjes së tij letrare. Neologjia e Qosjes përfshin krijimin dhe përdorimin e fjalëve të vjetra ose të njohura me kuptim të ri, të fjalëve, të shprehjeve dhe të ndërtimeve të farkuara mbi bazën e fjalëve të njohura ose përmes mjeteve të tjera gjuhësore, si dhe krijimeve të reja vetjake të quajtura kontekstuale. Studiuesja Islamaj shprehet se Qosja ka krijuar fjalë e shprehje të reja, duke respektuar frymën dhe normën gjuhësore të shqipes. Në këtë krijimtari ai ka shfrytëzuar edhe mundësi të fshehura e të pazbuluara të shqipes, në rend të parë ka shfrytëzuar begatinë e madhe fjalëformuese të shqipes (parashtesat, prapashtesat e ndajshatesat) mbi bazën e fjalëve të njohura duke u dhënë kuptime të reja ose duke zgjeruar rrezen e tyre semantike. Në romanet e tij gjenden numër i madh i neologjizmave morfologjikë, neologjizmave semantikë dhe ndërtime të reja shkencore sintaksore të quajtura neologjizma sintaksorë⁴, si: *shtjerremerr*, *nxitepërfito*, *kapemoseqit*, *shikodjathtasecmajtas*, *mirëupafsheve*, *hyrjedaljeve*, *shkoeardhjeve*, *nëveshpëshpëritjeve* etj. Ndërsa neologjizma me parashtesa, prapashtesa e ndajshetim mund të përmendim këtu: *përfolshmëri*, *i,e përdiellur*, *i përfytyrë*, *mbisundueshëm*, *nënnjeri*, *nënemër*, *paskajësi*, *i pafyeshëm*, *paramodern*, *tejfolje*, *henikor*, *humnenor*, *sendësor*, *kursimore*, *shpinore*, *ngushëllimtar*, *i idiotizuar*, *kushtrimues*,

⁴ Po aty, f. 81.

përkëdhelim, shejtanoj, shtrigoj, idioktik, leshxhinj, puthadorësit, puthakëmbësit, vështrimpërhumbur, gjashtëgishtakë, vetëmfolës, lakadredhash, bukurkuptimshëm, mezidukshëm etj. Formimet kompozitore dhe ato me përngjitje hasen shpesh në romanet e Qosjes, si: *kurmmagjepsur, kryegështenjzë, zemërbrazët, fytyrëbronzët, shtatlangore* etj. Me interes, dalin edhe fjalëformimet, të cilat zakonisht gjenden në tekste përshkruese për tipizimin e personazheve, si: *kokëtrekëndësh, kokëgjatë, kokëuljengritje, mendjetretur, trufasule, trutapë, sypërhumbur, fytyrëshkkurtër, fytyrëvuajtur, buzëvrenjtur, turimprehtë, turizgjatur, flokëdrejtë, këmbëzgjeruar, duartrokitës, kockëgjatë, bishtëtrashë* etj. Me interes dalin edhe formimet kompozitore me ndajshtesa të kategorive të ndryshme gramatikore, si: *i tingullkëndshëm, dhembjsjellës, fundbotshëm, gjysmëhënor, i askundshëm, i mirëdukshëm, i mirërenditur, shumëfushor, i mezivërejtur, vetëpyes, vetëzbuloj, vetëshpall* etj. Përmes çfarëdo rruge të jenë formuar neologjizmat e Rexhep Qosjes, qoftë fonologjike, qoftë morfologjike, qoftë leksikore e sintagmatike apo qoftë përmes huazimit, ato i janë nënshtruar përpunimit semantik në varësi nga konteksti ku janë aktualizuar, duke u dhënë atyre shënjeshtë të shumëkuptimshëm, shprehet Islamaj.⁵ Andaj, neologjizmat e Rexhep Qosjes ripohojnë të vërtetën se mundësitë dhe aftësitë e gjuhës janë të pakufishme dhe të pamatshme. Gjuha e veprave artistike të tij është krijuar mbi bazën e normës së gjuhës standarde, por hapësira e lirisë krijuese të shkrimtarit është larg më e gjerë e më e pasur, sepse ai synon ta individualizojë deri në fund gjuhën e tij poetike, synon të krijojë gjuhën e tij vetjake në pajtim me vizionin e tij vetjak për botën, prandaj i nënshtrohet kombinimeve dhe ndërthurjeve të pakufishme gjuhësore.⁶ Sa i përket pranimin të mundshëm të neologjizmave stilistikë të Qosjes, studiuesja Islamaj shprehet se tregues për pranimin e tyre në Fjalorin e shqipes janë: e reja që sjellin në gjuhë, përshtirja, denduria e përdorimit si dhe jetëgjatësia e tyre potenciale. Veçoritë kryesore të fjalëkrijimeve rastësore që i bëjnë të dallueshëm nga krijimet neologjike janë, ndërkaq, veçanësia, përshtatësia, natyrshmëria, papërsëritshmëria, rastësia, varësia nga konteksti, funksioni i tyre i veçantë, informacioni i ngjeshur, efekti i shprehur stilistik dhe pak ose aspak struktura e tyre fjalëformuese.⁷

Një aspekt shumë i rëndësishëm në veprën shkencore e publicistike si dhe në veprën letrare të Qosjes shquhet synimi i qartë për ta bërë shqipen gjuhë të zhvilluar, gjuhë të kulturës e të shkencës, shquhet dashuria e nderimi për gjuhën e kulturën kombëtare, shquhet vetëdija mbi vlerat e padiskutueshme gjuhësore të shqipes. Andaj kujdesi ndaj gjuhës, ndaj pastërtisë së saj është thelbësor, ndonëse nuk ka gjuhë pa elemente të huaja, purizmi i Qosjes sipas Islamajt shpreh tri veçori kryesore të vetë purizmit si dukuri e vetvetishme e çdo gjuhe: 1. Purizimi si përpjekje për pastrimin e gjuhës nga elemente të huaja gjuhësore 2. Purizimi si kërkesë ose veprim për ta liruara gjuhën nga elemente të vetë gjuhës që konsiderohen si të nënstandardit ose që kanë tingëllimën e thjeshtëligjërit a të gjuhës bisedore, dhe 3. Purizmi si kundërvënie ndaj përpjekjes që gjuha të zhvillohet në mënyrë plotësisht të pavarur, në të vërtetë stihike, me arsyetimin se ajo duhet të përmbushë në çfarëdo mënyre nevojat komunikuese dhe shprehëse. Me gjuhën e veprës së tij shkencore dhe në gjuhën e tij në përgjithësi dallohet qartë e lehtë kujdesi i studiuesit e i shkrimtarit që s'është së gjurmuar ndërrasuritë e shqipes, që s'është së përzgjedhuri në këtë pasuri e ndër mjetet e saj ato më të përshtatshmet në pajtim me atë që shkruan e për kohën kur shkruan, që s'është së krijuari fjalë e shprehje të reja, pasuruese për shqipen e sotme.

⁵ Po aty, f. 95.

⁶ Po aty, f. 95.

⁷ Po aty, f. 95.

Semantika në veprintarinë e Akad. Rexhep Qosjes

Brenda studimit të gjuhës së romaneve të Qosjes, prof. Islamaj u ka kushtuar vëmendje të merituar sinonimisë dhe antonimisë, si dukuri me denduri të lartë paraqitjeje në romanet e Qosjes. Prof. Islamaj ka hetuar se Qosja në romanet e tij ka gjurmuar me ngul në pasurinë e shqipes: në vertikalen dhe horizontalen e saj, prandaj shquajnë vargjet sinonimike që përbëhen prej elementeve të gjuhës shqipe në raport të lartë shpërpjesëtimi me sinonimet me burim të huaj. Shfrytëzimi i sinonimeve me burim të shqipes të shtresave të ndryshme leksikore nuk ka qëllim mënjanimin e

monotonisë, as edhe me përcaktimin sa më të saktë kuptimor, por me theks të veçantë efektin estetik. I vetëdijshëm për mundësitë gjuhësore e stilistike, i pajisur mirë me njohjet e gjuhës dhe të stilit, shkrimtari Qosja, në romanet e tij i është nënshtruar përzgjedhjes stilistike në të gjitha nivelet gjuhësore, prandaj dukuritë qendrore semantike, siç janë sinonimia dhe antonimia janë shfrytëzuar maksimalisht nga ai. Andaj, aty hasen sinonimet e plota, sinonimet e pjesshme, vargu sinonimik, çifti sinonimik, variacionet sinonimike, sinonimet kontestuale. Po ashtu, sipas prof. Islamajt, në romanet e Qosjes, si antonimia, si dukuri semantike, ashtu edhe antonimet, si kategori semantike-leksikore, zënë vend të rëndësishëm duke e bërë të veçantë nga shumë anë ligjërimin e tij letrar-artistik. Antonimia në romanet e tij ofron lëndë të pasur për të vështruar raportet e përbëra, të gjera dhe interesante, të ndërtuar në të shumtën e rasteve mbi parimin e kundërvënies, por edhe të afrisë. Ndaj në romanet e tij hetohen antonimet me rrënjë të ndryshme, antonimet me rrënjë të njëjtë, çifti antonimik, antonimet e plota, antonimet e pjesshme, antonimet kontestuale, antonimet sipas kategorive gramatikore.

Autorja në këtë monografi vend të veçantë u ka kushtuar edhe pjesëve të tjera, si stilistika tekstore-ligjërimore, ku ka trajtuar titujt, nëntitujt dhe motot-rëndësia kuptimore, simbolike dhe artistike, veçori mikrosintaksore, funksioni stilistik i emrave vetjakë dhe i emërtimeve të tjera, personazhet kryesore dhe simbolika e emrave të tyre, fjalitë nistore dhe fjalitë fundore. Në këtë pjesë vëmendje u ka kushtuar disa trajtimeve kuptimore, gjuhësore e stilistike të disa elementeve që janë trajtuar pak, si titujt, nëntitujt, motot, por edhe ndërtekstet e llojet e tjera paratekstore që ka përdorur shkrimtar në romanet e novelat e tij. Në romanet e Qosjes, autorja ka dalluar një varg elementesh në funksion të kodeve verbale e joverbale, që quhen paratekste dhe që shoqërojnë tekstin e tij narrativ. Elementet paratekstore dhe kontekstualizmi dëshmojnë për karakterin e romaneve të tij moderne dhe për prirjen nismëtare e postmoderne në letërsinë shqipe.

Pastaj autorja ka trajtuar çështje të stilistikës ligjërimore-stilore, ku me mjeshtëri ka vënë në pah pasurinë e profesor Qosjes, për temat shumësia tematike, strukturore, stinore dhe ligjërimore, ligjërimi emocional, romani si zbulim, risi në vend të konventave, shumësia stinore-ligjërimore e prozës dokumentare dhe tipat e ligjërimin të ditarëve, duke u ndalur në karakteristikat e secilës pjesë, të ilustruar edhe me shembuj nga krijimtaria e Rexhep Qosjes. Edhe këtu, sikurse në çdo pjesë, autorja pas hulumtimit dhe analizimit të materialit të vjelë nga krijimtaria e Qosjes del me përfundime për secilën pjesë. Romani “Nata është dita jonë”, të cilin e analizon në kapitullin shumësia tematike, strukturore, stinore dhe ligjërimore, sipas autores dallon nga romanet e letërsisë shqipe për mënyrën si i bashkon imagjinatën e njëmendësinë, për mënyrën e formimit artistik, për përdorimin e veçantë të gjuhës e të stilit dhe për estetikën e tij në përgjithësi. Romani ofron mundësi të pakufishme për të interpretuar temën, subjektin, idenë e sidomos strukturën e brendshme të të gjitha kuptimeve të tij asociative e simbolike. Në kapitullin e ligjërimin emocional, autorja ka arritur në përfundime se Qosja ka zhvilluar struktura të tilla narrative që zbulojnë strategji të përshtatshme ligjërimore që e bëjnë jo vetëm të shumëkuptimshëm e të shumëfigurshëm romanin, por edhe komunikimin me lexuesin. Studimi i ligjërimin emocional në këtë roman vërteton se gjuha shqipe është shumë e pasur me njësi gjuhësore: fjalë, togfjalësha, frazeologji e ndërtime sintaksore, që shprehin

gjendje nga më të ndryshmet emocionale. Sa i përket frazeologjisë së Qosjes, autorja zbulon se frazeologjia e tij i takon stilit libror po aq sa edhe stilit bisedor. Nga shqyrtimi i materialit, me numër më të madh dalin frazemat foljore, shënjuese ekspresive, frazemat me funksion fjalie, frazemat krahasuese, frazaman antonimike. Nga hulumtimet e autores rezulton se Qosja në asnjë periudhë të shkrimit të ditarit të vet nuk është nisur nga gjedhe paraprakisht të përcaktuara të shkrimit dituror, porse ka qenë kurdoherë i prirë të bashkojë tipa të ndryshëm shkrimorë, të ligjërimit e të stileve funksionale.

Prof. Islamaj e ka trajtuar edhe figurshmëria dhe teknika postmoderne, ku ka trajtuar shumësinë kuptimore dhe estetikën e metaforave, stilmatikën e krahasimit, epitetin dhe shumëllojësini e tij, ironinë dhe ndërtesktorësinë - zbulimin e stilit dhe të erudicionit, në romanet e Qosjes. Në këtë pjesë, studiuesja Islamaj, pas një pune hulumtuese dhe analizuese të krijimtarisë së Qosjes, ka ardhur në disa përfundime: metaforat e Rexhep Qosjes dëshmojnë se teksti i tij letrar-artistik është motivuar fuqishëm nga temat e mëdha jetësore të njeriut, siç janë jeta, vdekja, dashuria, shoqëria, natyra, ku më së shumti shquhet vdekja. Figura e krahasimit në romanet e shkrimtarit Rexhep Qosja është në funksion të nocionit, të idesë, të njohjes. Krahasimet e zhvilluara ashtu si edhe të gjitha sekuencat përshkruese në romanet e tij shprehin fuqinë e imagjinatës së tij krijuese. Mënyra e formësimit të llojeve të ndryshme të ligjërimit si dhe kombinimi i një numri të madh figurash në gjuhën e shkrimtarit krijon stil të veçantë që mund të marrë cilësinë stil inteligjent. Përsëritja është njëra ndër figurat stilistike dhe retorike që shquan ndjeshëm gjuhën e shkrimtarit. Paraqitja e epitetit në romanet e Qosjes njihet denduri të lartë përdorimi dhe ka më shumë se një funksion. Në kuadër të analizimit të krijimtarisë letrare të Qosjes, studiuesja Islamaj ka dalluar disa lloje epitetesh: epiteti metaforik, epiteti poetik, epiteti krahasues, epiteti metaforik, epiteti përshkrues, epiteti lirik, epiteti i ngjyrosur emocionalisht, epiteti i njëfishtë, dy, tre e më shumëfishtë etj. Ironia e shkrimtarit nuk ka vetëm funksion estetik, po krahas tij ka edhe funksion të iluminizmit. Ironia e Rexhep Qosjes është e shumëllojshme, e shumëkuptimshme dhe shumëndikuese. Të tillë e bëjnë përmbajtja, situata, personazhet, dialogët, monologët, ligjërimi, figurshmëria, gjuha, stili. Në prozën e shkrimtarit Rexhep Qosja njëra ndër veçoritë më dalluese e zhvillimit të saj estetik është përshtirja e lëndës tekstore, përkatësisht përfshirja në tekstin e tij letrar të sa më shumë hollësive dhe të aspekteve të njëmendësisë, të sa më shumë veprimeve e teknikave rrëfimore. Kjo veçori e gjithëpërfshirjes është e lidhur ngushtë me shmangien stilistike, si një prirje e kushtëzuar nga strategjia mbizotëruese e rrëfimit të tij.

Përfundime

Monografia *Ligjërimi, gjuha dhe stili në krijimtarinë letrare moderne dhe postmoderne të Rexhep Qosjes* kushtuar gjuhës dhe stilit të profesor Qosjes, studiuesve, albanologjisë, por edhe lexuesit të rëndomtë, vjen me një studim të thukët, përmbajtësor dhe mjaft vëllimor, ku vihet në pah gjuha dhe stili i një ndër shkrimtarëve e studiuesve të shquar të letërsisë shqipe. Ndonëse për veprimtarinë krijuese të profesor Qosjes janë bërë studime edhe më herët, kjo monografi vjen e veçantë, e përmbledhur e shteruese, e ndërtuar mbi bazën e një korpusi mjaft të begatshëm, duke plotësuar mozaikun e studimeve për profesor Qosjen. Krijimtaria e tij shkencore, letrare dhe gjuhësore, e provuar si në studimet e tij shkencore, si në veprat letrare e publicistike, shpreh përpjekjen që gjuha letrare shqipe të bëhet një gjuhë me aftësi të shprehura komunikuese, një gjuhë me fuqi të lartë shprehëse dhe një gjuhë e pasur me lëndën dhe mjetet e veta gjuhësore, sepse vetëm si e tillë ajo do të mund të sigurojë kontakt të dinjitetshëm me gjuhë e kultura të tjera. Me veprën e tij shkencore, letrar, publicistike e politike Rexhep Qosja ka dhënë një ndihmë të çmuar për lëvrimin dhe pasurimin e gjuhës standarde. Për më tepër gjuha e tij shkencore ka luajtur e vazhdon të luajë rol të drejtpërdrejtë në lëvrimin e stilit të ri shkencore e publicistik dhe të ligjërimit libror në përgjithësi. Andaj, prof. Shefkije Islamaj i ka

pasuruar studimet shqiptare me këtë monografi shteruese, duke studiuar gjuhën, stilin e ligjërimin e Akademik Rexhep Qosjes.

Referencat

- [1]. Rexhep Qosja, *Shefkije Islamaj – porterti intelektual, shkencore dhe letrar*, në Shefkije Islamaj, porterti intelektual, shkencor dhe letrar, Prishtinë, 2018, f. 21-36.
- [2]. Shefkije Islamaj, *Ligjërimi, gjuha dhe stili në krijimtarinë letrare modern dhe postmoderne të Rexhep Qosjes*, Prishtinë, 2021.
- [3]. Shefkije Islamaj, *Porterti intelektual, shkencor dhe letrar*, Konferencë shkencore me rastin e 65-vjetorit të lindjes së saj, Prishtinë, 2018.